



Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren
Fakulteti Ekonomik
Administrim Biznesi

PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS							
Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	Administrim Biznesi		Viti akademik	2019/20	
LËNDA		Parimet e Resurseve Humane					
Viti	II	Statusi i lëndës	E obliguar	Kodi		ECTS kredi	6
Semestri	IV						
Javët mësimore	15		Orët mësimore	45		Ligjërata	Ushtrime
						2	1
Metodologjia e mësimimit	Ligjërata, ushtrime, punime seminarike, konsultime, teste, raste studimi, detyra.						
Konsultime	Një orë para ligjëratave dhe një orë pas ligjëratave						
Mësimdhënësi	Prof. Asoc. Dr. Hamdi HOTI Ass. Leonora SOPI			e- mail	hamdi.hoti@uni-prizren.com		
				Tel.	383 44 205 116		

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Lënda ka për qëllim të ofroj njohuri të avancuara, të aftësoj studentët për përdorim specifik të koncepteve të teorive dhe të metodave nga Resurset Humane. Programi mësimor është i fokusuar në prezantimin e zhvillimeve të hershme të teorive që ndikojnë në menaxhimin e resurseve, pastaj mënyrën e organizimit të punës deri tek motivimi i punonjësve, vlerësimi dhe shpërblimi i performancës së tyre si dhe siguria në punë. Studentët të kuptojnë pse është i nevojshëm menaxhimi i Resurseve Humane.</p> <p>Studentët të fitojnë njohuritë për planifikimin, rekrutimin, seleksionimin, motivimin, komunikimin, zhvillimin, dhe vlerësimin e performancës.</p>	<p>Në mbarim të të mësuarit të lëndës, studentët duhet të jenë të aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Kuptojnë se menaxhimi i Resurseve Humane është proces për sigurimin e njerëzve të duhur në vendin e duhur dhe në kohën e duhur; ✓ Studentët të kuptojnë elementet themelore të menaxhimit të burimeve njerëzore; ✓ Kuptimin e aspekteve teorike dhe praktike mbi menaxhimin e Burimeve Njerëzore; ✓ Të hartoj, analizoj planin e kompensimit, planin dhe seleksionimin në një ndërmarrje; ✓ Të identifikoj faktorët e nevojshëm për të siguru një staf të motivuar dhe të suksesshëm.
Metodologjia për realizimin e temave mësimore:	
<p>Në dy orë ligjërata në javë dhe 1 orë ushtrime, do të shtjellohet materiali mësimor, dhe do të organizohet diskutim grupor. Do të prezantohen punime seminarike, të cilat pastaj do të prezantohen dhe diskutohen bashkërisht me studentet. Studentët inkurajohen që të përcjellin aspektet e menaxhimit dhe organizimit ne Institucione, ndërmarrje publike dhe private, dhe të nxjerrin tema për diskutim.</p> <p>Punimet lidhur me këto çështje do të kenë rëndësi për vlerësim. Përveç teksteve të detyrueshme, studentët do të kenë mundësi të shfrytëzojnë fondin e bibliotekës në UPZ dhe librarinë elektronike.</p> <p>Metoda e punës do të përqendrohet në ligjërata dhe ushtrime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimimit, me prezantime individuale e grupore, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Prezantimi i temës mësimore do të bëhet me projektor në Power Point; ✓ Raste studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar. 	
Ligjërata, ushtrime, qasje interaktive, konsultime, punime seminarike etj.	
Kushtet për realizimin e temës mësimore:	
Salla e pajisur me kompjuter/ Llaptop dhe projektor për prezantimin e materialit.	
Literatura adekuate, përdorimi i mjeteve të TI.	
Mënyra e vlerësimit të studentit (në %)	
✓ Testi I	25%
	Vlerësimi në %
	91-100
	Nota përfundimtare
	10 (dhjetë)

✓ Vijimi i ligjëratave	5 %	81-90	9 (nëntë)
✓ Angazhimi	10 %	71-80	8 (tetë)
✓ Punimi seminarik	10%	61-70	7 (shtatë)
✓ Provimi përfundimtar	<u>50%</u>	51-60	6 (gjashtë)
Totali	100 %	0-50	5 (pesë)

Obligimet e studentit:

Ligjërata ✓ Vijimi i rregullt i studentëve në ligjërata; ✓ Pjesëmarrja aktive në diskutime gjatë ligjëratave; ✓ Punimi seminarik; ✓ Pjesëmarrja në teste; ✓ Të përdorë literaturën e obliguar literaturë shtese; ✓ Të jetë aktiv dhe të respektoj rregullat mbi shkollimin e lartë të etikës në mirësjellje dhe për bashkëpunim; ✓ Provimi përfundimtar.	Ushtrime ✓ Pjesëmarrja aktive e studentëve në ushtrime; ✓ Puna grupore në raste studimi dhe detyra; ✓ Pjesëmarrja në diskutime lidhur me rastet studimore; ✓ Te reflektoj gatishmëri dhe dije për iniciativa, dhe demonstrim të njohurive të marrura në ligjërata.
--	---

Ngarkesa e studentit për lëndën

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2	15 javë	30 orë
Ushtrime	1	15 javë	15 orë
Punë praktike			
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	0.5 orë	15 javë	8 orë
Ushtrime në terren			
Seminare	0.5	10 javë	5
Detyra të shtëpisë	2	6	12
Koha e studimit vetanake	3	13 javë	40
Përgatitja përfundimtare për provim	3	13 Javë	40
Koha e kaluar në vlerësim(teste, provim final)			
Projekte,prezantime..etj			
Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim, p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		Ngarkesa totale:	150

Java	Ligjërata		Ushtrime	
	Tema	Orët	Tema	Orët
1.	Ligjërata hyrëse Zhvillimi i menaxhimit të burimeve njerëzore.	2	Pyetje për diskutim	1
2.	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (RH) Departamenti i burimeve njerëzore	2	Pyetje për diskutim dhe shembuj	1
3.	Mjedisi për MBNJ	2	Shembuj për organizimin e punës	1
4.	Organizimi dhe analiza e punës	2	Shembuj	1
5.	Planifikimi i Burimeve Njerezore	2	Shembuj praktik	1
6.	Rekrutimi	2	Pyetje për diskutim dhe shembuj	1
7.	Formimi	2	Shembuj praktik	1
8.	Tema: T e s t i I	2	Ushtrime	1

9.	Vlerësimi i performancës	2	Shembuj praktik	1
10.	Menaxhimi i Shpërblimit	2	Shembuj	1
11.	Përfitimet e punëtorëve	2	Pyetje për diskutim, shembuj.	1
12.	Marrëdhëniet e punës	2	Shembuj	1
13.	Kontratat Kolektive	2	Shembuj	1
14.	Shëndeti dhe siguria në punë, qëllimi dhe rëndësia, risqet në shëndetin dhe sigurinë në punë.	2	Shembuj dhe diskutime	1
15.	Përmbledhje e materialit Përgatitje për provim.		Shembuj dhe diskutime	

LITERATURA:

Literatura bazë:

- ✓ Manaxhimi i Burimeve Njerëzore, Dr. Shyqri LLACI, Dr. Zana KOLI, Tiranë,
- ✓ Principles of Human Resource Management.

Literatura shtesë:

- ✓ Paul Banfield-Rebecca Kay: Hyrje në Menaxhimin e Burimeve njerëzore, Përkthim: Jonida Bregu, Botimi UET Press 2011 Tiranë;
- ✓ Prof. Dr. Galantina Canco (Doraci): Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Tiranë 2009;
- ✓ Menaxhimi i Resurseve Humane, Tekst universitar, Ymer Havolli, Riinvest, Prishtinë, 2003;
- ✓ Manaxhimi i Burimeve Njerëzore, Raste studimi, Ushtrime; Dr. Ilirjan LIPI;
- ✓ Menaxhimi i resurseve humane, Enver KUTLLOVCI, Prishtinë, 2004;
- ✓ Metodologjia e punës shkencore kërkimore: Ali JAKUPI, dispensë, Prishtinë;
- ✓ Metodologjia e punës kërkimore shkencore për biznes, Nexhmi REXHA, Ligjërata të autorizuara, 2005 Prishtinë;
- ✓ Human Resource Management, Alan Price 2007 UK;
- ✓ Human Resource Management, J. Bratton, J. Gold 2006 UK;
- ✓ Literaturë tjetër dhe materiale të ndryshme nga interneti.

Gjuhen angleze:

- ✓ H T Graham & Roger Bennett: Human Resources management, Great Britain 1998.

VËREJTJE:

- ✓ Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe;
- ✓ Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me temën e ligjëruar;
- ✓ Rezultatet e arritura nga detyrat, grupet e studentëve duhet ti prezantojnë dhe t'i diskutojnë në orën e ushtrimeve.

Vërejtje për studentin:

Para së gjithash, studentin duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore:

- ✓ Të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- ✓ Të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- ✓ Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit/ ID-së në teste dhe provim;
- ✓ Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studentin duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.